



BACHELOR

INXHINIERI MJEDISI DHE UJI

NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU

Pse ky program studimi?

Programi Bachelor në "Inxhinieri Mjedi dhe Uji" është i domosdoshëm për t'iu përgjigjur sfidave bashkëkohore të ndryshimeve klimatike, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe mbrojtjes së mjedisit.

Programi është hartuar në përputhje me standardet akademike të Universitetit BOKU, në Vjenë.

Ai ndërthur parimet e inxhinierisë me shkencat mjedisore dhe burimet natyrore, duke përgatitur specialistë të kualifikuar, me njohuri teorike dhe praktike, të orientuar drejt tregut të punës dhe prioriteteve kombëtare dhe evropiane të zhvillimit të qëndrueshëm.

Diplomë që njihet ndërkombëtarisht



Përshkrimi i programit

Një program ndërdisiplinor që kombinon konceptet kryesore të inxhinierisë me shkencat mjedisore për të studiuar dinamikën e ujit, tokën, ajrin dhe biodiversitetin. Programi synon të përgatisë profesionistë në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe burimeve natyrore, reduktimit të ndotjes, si dhe hartimit dhe zbatimit të zgjidhjeve teknike dhe të bazuara në natyrë për problematikat mjedisore, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Profili i të diplomuarit / Profil profesional

I diplomuari në Bachelor "Inxhinieri Mjedisi dhe Uji" është profesionist i përgatitur për të punuar në analizimin, projektimin dhe menaxhimin e sistemeve mjedisore dhe ujore. Ai zotëron aftësi për monitorimin e cilësisë së ujit, tokës dhe ajrit, vlerësimin e ndikimeve mjedisore, menaxhimin e ndotjes dhe zbatimin e standardeve kombëtare dhe evropiane. I diplomuari është i aftë të përdorë mjete inxhinierike dhe digjitale, të kontribuojë në projekte ndërdisiplinore, të hartojë zgjidhje të bazuara në natyrë dhe të veprojë në sektorin publik, privat apo organizata ndërkombëtare, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve natyrore.



Denisa Mehaj

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

"Studimet në *Inxhinieri Mjedisi* më kanë pajisur me njohuri mbi legjislacionin mjedisor dhe VNM-në. Në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit merrem me analizën teknike të raporteve dhe vlerësimin e përputhshmërisë së projekteve me standardet ligjore."



Andi Toska

Specialist Mjedisi

"Ky program që ofron UBT më ka pajisur me njohuri mbi menaxhimin mjedisor dhe legjislacionin. Si specialist mjedisor, monitoroj dhe raportoj ndikimet mjedisore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm."



Odetta Shkurtaj

Agjencia Kombëtare e Bregdetit

"Studimet në UBT më kanë pajisur me njohuri mbi menaxhimin e zonave bregdetare dhe legjislacionin mjedisor. Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit angazhohem në vlerësimin e ndërhyrjeve dhe ndikimeve mjedisore."



Arlinda Shehu

Specialiste, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

"Me formim në shkencat e mjedisit dhe angazhim pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, punoj për zbatimin e standardeve mjedisore dhe një zhvillim të qëndrueshëm të territorit."

Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë këto kompetenca kryesore:

- Menaxhimi i rrjeteve të ujësjellësit, sistemeve ujitëse dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.
- Projektimi i zgjidhjeve teknike dhe të bazuara në natyrë për rehabilitimin e zonave të ndotura dhe zhvillimin e infrastrukturës së gjelbër.
- Menaxhimi i tokës, ujërave, kimikateve dhe mbetjeve në kuader të ekonomisë qarkulluese dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Hartimi i VNM/VNMS-ve dhe planeve të menaxhimit mjedisor (PMM).
- Monitorimi i parametrave mjedisorë, vlerësimi i ndikimit dhe përhapjes së ndotësve në mjedis, përdorimi i modeleve mjedisore, si dhe zbatimi i legjislacionit mjedisor dhe direktivave të BE-së.

PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

LËNDËT BAZË

Kimi,
Fizikë dhe meteorologji,
Matematikë e aplikuar,
Statistikë,
Gjeologji dhe hidrologji,
Botanikë,
Ekologji,
Hidrobiologji dhe mikrobiologji
mjedisore.

LËNDËT KARAKTERIZUESE

Shkencë Toke, Inxhinieri
hidraulike, Hidrologji inxhinierike,
Ndotje mjedisi, Inxhinieri e
proceseve, Menaxhimi i tokës dhe
ujërave, Ekonomi qarkulluese,
Monitorimi i cilësisë së ujërave,
Menaxhimi i ndotjes dhe
mbetjeve, Vlerësimi dhe
menaxhim i rrishtit mjedisor,
Ruajtja e biodiversitetit.

TË TJERA

Shkenca sociale,
Planifikimi hapësinor,
Kërkim shkencor,
Bazat e prodhimit bujqësor,
Teknologji gjeohapësinore,
Ekskursionet dhe praktikë në
teren.

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike dhe aktiviteteve në terren.

Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme

Mundësi Punësimi:

- Punësim në sektorin publik dhe privat si inxhinierë mjedisi dhe uji, specialistë mjedisi dhe ekspertë projektuesh.
- Angazhim në institucione shtetërore, agjenci mjedisi, kompani konsulence, industri dhe ndërmarrje të ujësjellës-kanalizimeve.
- Mundësi pune në projekte infrastrukturore, rehabilitim mjedisor, përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike dhe projekte të financuara nga BE.
- Aktivitet profesional në universitete, institute kërkimore, organizata ndërkombëtare dhe si këshilltarë për politika mjedisore.

Të dhënat e programit

Niveli i studimit

Cikli i parë, Bachelor

Titulli akademik

Bachelor në Inxhinieri Mjedisi dhe Uji

Kohëzgjatja

3 vite akademike/6 semestra

Kredite

80 ECTS

Forma e studimit

Me kohë të plotë

Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

Kuota studimi

120 studentë

Përfundimi i studimeve

Provim formimi / Temë diplome



Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz.

Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



Për më shumë informacion vizitoni
UBT.EDU.AL

MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Të diplomuarit kanë mundësi të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë Master në fusha të lidhura me inxhinierinë mjedisore, menaxhimin e ujit, burimeve natyrore, shkencat mjedisore dhe planifikimin territorial. Programi siguron bazë të fortë teorike dhe praktike për ndjekjen e mastereve shkencore dhe profesionale në UBT, universitete të tjera në Shqipëri, si dhe në universitete evropiane, përfshirë programe të përafruara me ato të BOKU, Vjenë.

FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti_bujqesor_tiranes
fbm_ubt



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare
Fakulteti I Bujqësisë dhe Mjedisit- Faqja Zyrtare

Për jetën dhe të ardhmen...